

Vendim nr. 140 datë 26.06.2023

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Elsa Toska, anëtarë, në datën 26.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (Sh)/1 2023 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: QENDRA “RES PUBLICA”,
SHOQATA “IMPETUS”

OBJEKTI: Shfuqizimi i ligjit nr. 38/2021, datë 23.03.2021 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë “Bechtel International Inc.”, për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 11, 17, 18, 41, 42, 49, 56, 131, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 8, 10 dhe 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), nenet 6 e vijues të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit” (*Konventa e Aarhus-it*), të ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000; nenet 27, 47, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 23.03.2021, me propozim të Këshillit të Ministrave, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 38/2021 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë “Bechtel International Inc.” për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës” (*ligji nr. 38/2021*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 62, datë 20.04.2021 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në këtë fletore. Qëllimi i tij është autorizimi dhe përcaktimi i procedurës së veçantë për negocimin, ekzekutimin dhe miratimin e kontratës me shoqërinë “Bechtel International Inc.” (*shoqëria “Bechtel”*), ose një filial të saj, për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, bazuar në shprehjen e interesit paraprak të depozituar në ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë (*neni 1*).

2. Sipas këtij ligji, kontrata për realizimin e këtij projekti ndahet në dy faza. Kontrata e fazës së parë përfshin aktivitetet paraprake të punës që do t’i mundësojnë shoqërisë “Bechtel” të paraqesë një propozim tek autoriteti kontraktues për kontratën e fazës së dytë dhe të ndihmojë autoritetin kontraktues e Këshillin e Ministrave në sigurimin e mbështetjes financiare për projektin, ndërsa faza e dytë konsiston në projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Kontrata e fazës së parë përfshin realizimin e veprimtarive të tilla si: a) matje topografike dhe studime hidrologjike në mbështetje të zhvillimit të projektimit; b) studime dhe inspektime gjeoteknike në terren; c) zhvillimin e strategjisë për realizimin e projektit; ç) rishikimin dhe finalizimin e vlerësimit të ndikimit mjedisor e social; d) përgatitjen e projektit teknik, përfshirë përzgjedhjen e furnitorit të turbinave, me qëllim preventimin e kostove dhe të sasive; dh) shërbime të tjera të dakordësuara për të mundësuar ecurinë e zhvillimit të projektimit të hidrocentralit të Skavicës (*neni 2, pikat 1 dhe 2*). Shpenzimet për mbulimin e kontratës së fazës së parë mbulohen nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), e cila kryen oponencë për veprimtaritë e fazës së parë të paraqitura nga Bechtel-i vetë dhe/ose me anë të institucioneve përgjegjëse shqiptare (*neni 2, pika 3*).

3. Ligji ka parashikuar, gjithashtu, procedurat për negocimin e kontratës, nënshkrimin dhe miratimin e saj, si dhe realizimin e projektit (*nenet 3, 4 dhe 5*). Kështu, kontratat e të dy fazave nënshkruhen nga KESH-i, në cilësinë e autoritetit kontraktues, ndërsa ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë mbikëqyr të gjithë procesin, nga firmosja e marrëveshjes deri tek ekzekutimi i saj. Procedura e negocimit për finalizimin e kontratës së fazës së parë zhvillohet nga KESH-i, ndërsa ajo e negocimit për fazën e dytë të kontratës

zhvillohet nga Komisioni i Negocimit (KN), i krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM), me përfaqësues të KESH-it, ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë dhe të ministrave të tjera të linjës, ose organeve të tjera, sipas përcaktimit në vendim.

4. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave kontratën e nënshkruar mes KESH-it dhe shoqërisë “Bechtel” të lidhur me fazën e parë të projektit. Data e hyrjes në fuqi të kontratës për fazën e parë të projektit është data e hyrjes në fuqi të VKM-së që e miraton atë. Për sa i përket kontratës së fazës së dytë, ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë përgatit dhe dërgon te Këshilli i Ministrave projektligjin për miratimin e saj. Kjo kontratë miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të ligjit miratues.

5. Në datën 04.05.2023 qendra “Res Publica”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), shoqata “Impetus” dhe shoqata “Për mbrojtjen e pronave dhe mjedisit të pellgut të Drinit të Zi” (kërkueset) i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr. 38/2021, duke pretenduar se ai cenon të drejtat kushtetuese. Në datën 06.06.2023 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa në datën 26.06.2023, kjo e fundit ka vendosur ndarjen e çështjes dhe shqyrtimin veçmas të kërkesës së qendrës “Res Publica” dhe shoqatës “Impetus” nga kërkesa e KSHH-së dhe shoqatës “Për mbrojtjen e pronave të mjedisit të pellgut të Drinit të Zi”, për të vlerësuar nëse kërkesa e dy të parave plotësonte kriteret paraprake për shqyrtim në seancë plenare.

II

Pretendimet e kërkueseve

6. **Kërkueset**, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar:

Për legjitimitimin:

6.1. Në një shtet të së drejtës Gjykata mund të vihet në lëvizje edhe nga subjekte të posaçme, për shkak të interesit të përgjithshëm publik për sundimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës, çka justifikohet në rastin konkret, pasi ligji i kundërshtuar shfaq probleme të papajtueshmërisë me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Kërkueset nuk mund t’u drejtohen gjykatave të zakonshme, pasi ato nuk përbëjnë mjete efektive ankimi, duke qenë se nuk mund të shqyrtojnë dhe shfuqizojnë ligjet. Ankime të tilla do të ishin iluzore dhe nuk do të parandalonin jo vetëm pasojat e

menjëhershme, të rënda dhe të pariparueshme, por edhe zgjidhjet afatgjata, duke humbur tërësisht kuptimin e mjetit efektiv të ankimit.

Për kundërshtimin e ligjit nr. 38/2021:

6.2. Ligji cenon *parimin e sigurisë juridike në lidhje me parimin e proporcionalitetit*, pasi:

6.2.1. Përfshihet në mënyrë të pajustificuar zbatimin e akteve ligjore që mundësojnë një sërë të drejtash dhe lirish kushtetuese si: drejtësia shoqërore, liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale e kulturore, të drejtën për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, identitetin dhe trashëgiminë kombëtare, barazinë përpara ligjit dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike. Ligji nuk është paraprirë nga studime, analiza e vlerësime të mjaftueshme për të përcaktuar paraprakisht interesat që mund të preken nga zhvillimi i projektit, çka e bën të vështirë, në mos të pamundur, kthimin prapa, nëse gjatë zbatimit të tij verifikohen efekte negative. Hapësira që ai lejon për përfshirjen e publikut gjatë fazës së parë të kontratës është minimale, e vonuar, joefektive dhe pa ndikim në vendimmarrje. Ligji nuk parashikon asnjë instrument ose mekanizëm për ndalimin e veprimeve të mëtejshme në zbatim të tij, ndërsa ka bërë fakt të kryer lidhjen dhe zbatimin e kontratave, sipas propozimeve të kontraktorit të përzgjedhur. Ndonëse shoqëria “Bechtel” është në proces të përgatitjes së raportit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS), ky vlerësim nuk përmbush garancitë e duhura ligjore të publikut të prekur dhe të atij të interesuar për mbrojtjen e mjedisit, pronave, trashëgimisë kulturore dhe aspekteve të tjera social-ekonomike.

6.2.2. Ndërkohë që në relacionin shoqërues të projektligjit pranohet se sektori i energjisë përbën interes kombëtar e thelbësor për vendin dhe se ndërtimi i projektit bazohet në shprehjen e interesit paraprak, ligji përzgjedh në mënyrë ekskluzive, pa procedura konkurruese, një subjekt të vetëm për realizimin e projektit, shoqërinë “Bechtel”, duke i vënë në dispozicion fonde publike për realizimin vetë, ose përmes palëve të treta të përzgjedhura nga ky subjekt, të studimeve dhe vlerësimeve paraprake. Ligji është bazuar në memorandumin e bashkëpunimit ekonomik për projektet dhe blerjet, të lidhur mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili jo vetëm që nuk parashikon mundësinë e një zgjidhjeje të tillë, por synon procese të hapura prokurimi,

investime të hapura dhe jodiskriminuese, standarde të larta në lidhje me shëndetin, sigurinë, mjedisin, punën, transparencën, si dhe qeverisjen e mirë.

6.2.3. Në drejtim të *parimit të proporcionalitetit*, ligjvënësi nuk ka dhënë asnjë informacion ose arsye për nevojën e miratimit të ligjit, pse nuk janë bërë analiza, studime dhe vlerësime paraprake, si dhe pse janë përjashtuar dhe shmangur nga zbatimi rregullimet ligjore ekzistuese. Këshilli i Ministrave dhe ligjvënësi nuk kanë arritur të përcaktojnë ekzistencën e interesit publik specifik, që justifikon ndërhyrjen e posaçme me ligjin nr. 38/2021, i cili nuk përfshihet në objektin e ligjit për investimet strategjike, për rrjedhojë ndërhyrja përmes tij është e pajustificuar.

6.3. *Identitetin kombëtar, në drejtim të trashëgimisë kombëtare e kulturore*, pasi ndërtimi i HEC-it të Skavicës rrezikon humbjen e kulturës, të qytetërimit mijërvjeçar, të vlerave historike, si dhe atyre materialo-shpirtërore të banorëve të zonës, të lidhura me tokën, shtëpinë, krahinën, këngët dhe vallet, veshjen, traditat, varret e të parëve, të shkuarën etj. Miratimi i ligjit është bërë pa një vlerësim të trashëgimisë kulturore të ndodhur në zonën që rrezikon të përmbetet, në të cilën ndodhen një sërë objektesh të trashëgimisë kulturore të përcaktuara si të mbrojtura, si dhe një sërë të tjerash që meritojnë mbrojtje.

6.4. *Të drejtën për t'u informuar për gjendjen e mjedisit*, të garantuar nga neni 56 i Kushtetutës, Konventa e Aarhus-it dhe ligjet për njoftimin dhe konsultimin publik dhe për mbrojtjen e mjedisit, për shkak të mospërbushjes së detyrimit për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrje; mosadresimit, përmes një procesi informues e konsultues, të kufizimeve eventuale të të drejtave dhe ndikimit të ligjit në to; mospërgatitjes së raportit të VSMN-së së projektit për ndërtimin e HEC-it të Skavicës, i cili duhej të ishte gati për opinionet dhe komentet e publikut që në tremujorin e tretë të vitit 2022.

6.5. *Të drejtat dhe liritë me karakter ekonomik, pronësor, social e kulturor të lidhura me të drejtën për një mjedis të shëndetshëm*, të garantuara nga nenet 3, 41, 49 dhe 56 të Kushtetutës, nenet 8, 10 dhe 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe një sërë aktesh ligjore e nënligjore, pasi ligji i kundërshtuar i është shmangur zbatimit të këtyre akteve. Ndërtimi i HEC-it të Skavicës nuk është parashikuar as në Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018-2030 dhe as në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Dibër. Si i tillë, ai i duhej nënshtruar procesit të vlerësimit

strategjik mjedisor, sipas ligjit. Nga ana tjetër, zhvillimi i një projekti të tillë do të çojë në përmbytjen e zonave të prekura dhe shpërnguljen masive të popullsisë, duke cenuar pronat, banesat, lirinë e tyre për të zgjedhur aktivitetin ekonomik e punësimin, zhvillimin njerëzor, si dhe cilësinë e jetës.

6.6. *Lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe konkurrencën e lirë në lidhje me parimin e barazisë përpara ligjit*, të garantuara nga nenet 11, 17 dhe 18 të Kushtetutës, *Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA)*, ligjet për prokurimin publik dhe për koncesionet dhe partneritetin publik privat, pasi kompanisë kontraktuese i janë dhënë të drejta dhe avantazhe ekskluzive në planifikimin, hartimin, përzgjedhjen e zinxhirit të furnizimit dhe zbatimin e projektit publik, i cili në fazën e parë do të financohet nga fonde publike të gatshme, ndërsa në fazën e dytë përmes kredisë së siguruar nga institucionet ndërkombëtare, duke paguar në këtë mënyrë kontraktorin me fonde publike edhe për ndërtimin e veprës. Ligji cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike në drejtim të parimeve të konkurrencës së lirë, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të kompanive shqiptare ose të huaja, potencialisht të afta dhe të interesuara për të konkurruar për realizimin e projektit, të cilat janë përjashtuar automatikisht nga kjo mundësi.

6.7. *Traktatin e Komunitetit të Energjisë (TKE)*, të ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 03.04.2006 “Për ratifikimin e Traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë”, si dhe *acquis communautaire* të nxjerrë në kuadër tij, si: direktivat e Bashkimit Evropian “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara” e “Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private”.

6.8. Ligji cenon nenet 101, 102 dhe 107 të *Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFBE)*, për sa i përket ndalimit të marrëveshjeve antikonkurruese, ndalimit të abuzimit me pozitën dominuese e ndalimit të ndihmës shtetërore të dhënë në kundërshtim me TFBE-në dhe TKE-në.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkueseve

7. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të

kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur për shqyrtim përpara Gjykatës.

8. Në kërkesën për shfuqizimin e ligjit nr. 38/2021, kërkuueset kanë pretenduar se Gjykata mund të vihet në lëvizje edhe nga subjekte të posaçme, për shkak të interesit të përgjithshëm publik për sundimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës, çka justifikohet në rastin konkret, pasi ligji i kundërshtuar shfaq probleme të papajtueshmërisë me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Sipas tyre, gjykatat e zakonshme nuk përbëjnë mjete efektive ankimi, duke qenë se nuk mund të shqyrtojnë dhe shfuqizojnë ligjet. Ankime të tilla do të ishin iluzore dhe nuk do të parandalonin jo vetëm pasojat e menjëhershme, të rënda dhe të pariparueshme, por edhe zgjidhjet afatgjata, duke humbur tërësisht kuptimin e mjetit efektiv të ankimit.

9. Për legjitimimin e organizatave, si subjekte që e vënë në lëvizje, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës, ato legjitimohen për t’iu drejtuar Gjykatës për pajtueshmërinë e normës me Kushtetutën vetëm nëse përmbushin kushtin e kërkuar nga paragrafi 2 i nenit 134 të Kushtetutës, për të argumentuar “interesin e tyre” në një “çështje të veçantë”. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimet nr. 38, datë 09.12.2022; nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 20, datë 20.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka theksuar se në çështje të kontrollit kushtetues të normës organizata duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë dhe normës që kundërshton. Vetëm fakti se akti i kundërshtuar mund të ketë ose ka pasur një efekt çfarëdo për kërkuesen, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ajo legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së saj, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Po kështu, sipas Gjykatës, vlerësimi nëse një subjekt i kushtëzuar ka ose jo mjaftueshëm interes për vënien në lëvizje të saj për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës,

bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë (*shih vendimet nr. 38, datë 09.12.2022; nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, nisur nga qëllimi i ndryshëm i veprimtarisë së dy OJF-ve, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson t'i trajtojë veçmas, për secilën prej tyre, legjitimitimin kushtetues për vënien në lëvizje të Gjykatës për kundërshtimin e ligjit nr. 38/2021.

A.1. Për legjitimitimin e qendrës “Res Publica”

13. Qendra “Res Publica” është regjistruar si person juridik, organizatë jofitimprurëse (OJF), me vendimin nr. 604, datë 13.04.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Qëllimi i veprimtarisë së saj është, ndër të tjera, të mbrojë liritë dhe të drejtat themelore të kategorive të pambrojtura e të interesave të tjerë të ligjshëm të tyre; të ofrojë shërbime këshillimi, përfaqësimi ose të mbrojtjes juridike në proceset gjyqësore; të kontribuojë në edukimin e sensibilizimin e publikut për probleme akute sociale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë problemeve të kategorive të pambrojtura; të promovojë nisma për afirmimin e të drejtave themelore të personave dhe favorizimin e integritetit social e kulturor të kategorive në nevojë; të informojë mbi sistemin ligjor shqiptar; të promovojë ndihmën juridike pa pagesë në rrugë gjyqësore e jashtëgjyqësore dhe të forcojë kulturën pro-bono në komunitet; të promovojë shkëmbimin e informacionit për të përmirësuar shërbimet ligjore dhe për t'i përshtatur me nevojat e shoqërisë; të promovojë barazinë për të gjithë individët; të zhvillojë dhe forcojë bashkëpunimin me partnerë, të tjera subjekte publike dhe private, institucione të arsimit të lartë, institucione që ushtrojnë veprimtari social-kulturore ose që kanë qëllime të ngjashme dhe që i bashkon misioni dhe qëllimet e zyrës pro-bono; të krijojë një qendër dokumentimi mbi të drejtat dhe diskriminimin social; të këshillojë institucione publike e subjekte të tjera për çështje të hartimit të politikave të ndryshme; të kryejë veprimtari të tjera në të mirë dhe në interes të publikut, duke kuptuar çdo veprimtari që mbështet dhe zhvillon tek individit e shoqëria vlera shpirtërore dhe vlera të tjera humanitare, mbron jetën e njeriut, shëndetin e tij, siguron dhe realizon shërbime publike dhe sociale, ndihma dhe mbështetje në raste fatkeqësish, mbron mjedisin dhe zhvillon kulturën dhe edukatën ndaj tij, mbështet e zhvillon vlerat dhe traditat kulturore e historike, shkencën, arsimimin, edukimin fizik dhe shpirtëror, jep ndihmesë në zhvillimin e zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo drejtim tjetër në interes të publikut; të bashkëpunojë me grupet identitare për përmbushjen e qëllimit.

14. Në drejtim të legjitimitetit formal të kësaj kërkueseje, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se qendra “Res Publica” është regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Po

kështu, kërkesa drejtuar Gjykatës është nënshkruar nga drejtori ekzekutiv i saj, i cili, sipas statutit, gëzon të drejtën e përfaqësimit në Gjykatë. Në kërkesën e saj kërkesja ka kërkuar shfuqizimin e ligjit nr. 38/2021, duke pretenduar se ai cenon parimin e sigurisë juridike në lidhje me parimin e proporcionalitetit; identitetin kombëtar, në drejtim të trashëgimisë kombëtare e kulturore; të drejtën për t'u informuar për gjendjen e mjedisit; të drejtat dhe liritë me karakter ekonomik, pronësor, social e kulturor të lidhura me të drejtën për një mjedis të shëndetshëm; lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe konkurrencën e lirë në lidhje me parimin e barazisë përpara ligjit; MSA-në, TKE-në dhe TFBE-në.

15. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se, si subjekte të përcaktuara në nenin 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës një organizatë mund t'i drejtohet Gjykatës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së normës në rastet kur arrin të provojë se norma e kundërshtuar prek qëllimet e veprimtarisë së saj, interesat e anëtarëve të saj ose të subjekteve që ajo mbron, sipas statutit. Në analizë të qëllimit të veprimtarisë së qendrës “Res Publica”, sipas statutit të kësaj organizate, në raport me kërkimet dhe argumentet e parashtruara prej saj përpara Gjykatës për kundërshtimin e ligjit nr. 38/2021, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se asnjë nga qëllimet e veprimtarisë së saj nuk mund të konsiderohet se legjitimon atë në këndvështrimin kushtetues për kundërshtimin e normës ligjore konkrete. Argumentet e parashtruara nga kërkesja se gëzon personalitetin juridik sipas ligjit dhe se interesi i përgjithshëm publik për sundimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës e legjitimon atë në kontrollin kushtetues të normës konkrete, kanë karakter të përgjithshëm dhe nuk rezulton të jenë të lidhura me veprimtarinë që ajo ushtron. Edhe nëse do të pranohej se norma e kundërshtuar prek atë pjesë të veprimtarisë së kërkeses që synon mbrojtjen e mjedisit, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ajo nuk ka arritur të provojë konkretisht cenimin e veprimtarisë së saj praktike në këtë drejtim. Në këtë kuptim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se veprimtaria e kërkeses nuk rezulton të jetë e lidhur mjaftueshmërisht me normën e kundërshtuar, në një masë të tillë që të legjitimojë atë në kërkesën e saj sipas objektit.

16. Për sa i përket interesit të anëtarëve të organizatës ose të subjekteve, të drejtat e të cilave një organizatë mbron, sipas statutit, si kriter për legjitimimin kushtetues të organizatës, në këndvështrim të standardeve të mësipërme (*shih paragrafin 9 të vendimit*), Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkesja nuk ka arritur të individualizojë ose të përcaktojë në nivel kushtetues ndikimin e drejtpërdrejtë të ligjit të kundërshtuar në interesat e anëtarëve të saj ose të subjekteve, interesat e të cilëve mbron. Fakti që ligji prek disa të drejta kushtetuese, në vetvete, nuk është i mjaftueshëm për të provuar në aspektin kushtetues legjitimimin e organizatës në lidhje me këtë kriter. Në këtë kuptim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se qendra

“Res Publica” nuk ka arritur të provojë përpara Gjykatës se në çfarë mase anëtarët e saj ose subjektet, interesat e të cilave ajo mbron, janë në marrëdhënie të tilla që rregullohen nga ligji i kundërshtuar, si dhe se sa reale ose potenciale është pasoja që pretendohet se u është shkaktuar interesave të tyre.

17. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se qendra “Res Publica” nuk legjitimohet *ratione personae* për vënien në lëvizje të Gjykatës për kontrollin kushtetues të ligjit nr. 38/2021.

A.2. Për legjitimimin e shoqatës “Impetus”

18. Shoqata “Impetus” është regjistruar si person juridik, OJF, me vendimin nr. 5541, datë 08.02.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo ka për qëllim të veprimtarisë së saj të fuqizojë aftësinë e qytetarëve dhe grupeve shoqërore për të ndikuar në të gjitha çështjet që prekin ata dhe komunitetet e tyre; të mbështesë përfshirjen, barazinë e mundësive dhe antidiskriminimin; të mbrojë kauzat e qytetarëve përkundrejt institucioneve dhe kompanive publike, atyre private dhe partive politike, në të gjitha fushat ku ata janë palë interesi. Prioriteti dhe fokusi kryesor i shoqatës, në mënyrë të veçantë, janë: antikorrupsioni në institucionet dhe kompanitë publike ose kompanitë ku ka një marrëveshje të llojit partneritet publik-privat ose koncesionar, si dhe eliminimi e qartësimi i praktikave evazive të akteve nënligjore e udhëzimeve që rrjedhin prej tyre, që lënë vend për subjektivizëm e korrupsion; e drejta e qytetarëve për të kërkuar zbatimin e njëtrajtshëm e joselektiv të ligjeve, akteve nënligjore e udhëzimeve ose praktikave që rrjedhin prej tyre; ruajtja dhe respektimi nga entet publike ose private i ligjeve, standardeve dhe praktikave më të larta mjedisore për qytetarët shqiptarë; respektimi rigoroz i të drejtave të qytetarëve dhe grupeve të interesit për t’u konsultuar paraprakisht për çdo ligj të ri ose ndryshim të Kushtetutës, ligjeve, akteve nënligjore, urdhrave apo udhëzimeve që rrjedhin nga to; mbrojtja e konsumatorëve ndaj produkteve të çdo lloji jashtë standardit ligjor dhe e drejta tyre për të pasur një informacion të shkruar dhe të qartë për produktet që tregtohen në treg; zhvillimi urban, planet, studimet urbanistike dhe lejet zhvillimore e ndërtimore që pasojnë si një shqetësim themeltar me të cilin po përballlet shoqëria, si dhe informimi e transparenca e qytetarëve nga organet që marrin këto vendime përpara dhe gjatë mbledhjeve; organizimi i qytetarëve për të kërkuar e organizuar referendume lokale e kombëtare, si dhe kërkesa për ligje dhe akte nënligjore e udhëzime të qarta për qytetarët për të ushtruar të drejtën e organizimit dhe kërkesës për referendum; organizimin e bojkoteve ndaj enteve e kompanive që standardet më të larta evropiane për të cilat shoqëria aspiron; mbrojtja e

qytetarëve, organizatave e kompanive private ndaj taksimit e tarifave të padrejta, të pajustificuara ose abuzive; e drejta e qytetarëve, organizatave dhe kompanive private për t'u trajtuar të barabartë me institucionet e kompanitë publike përpara praktikave ligjore, nënligjore ose udhëzimeve që rrjedhin prej tyre; mbështetja për një media transparente dhe të pavarur ose ndërruar nga politika, si dhe krijimi i instrumenteve të saj mediatike për të mbështetur qëllimet dhe fushat e saj të veprimtarisë; respektimi i konventave evropiane dhe ndërkombëtare të pranura nga shteti shqiptar.

19. Në drejtim të legjitimitetit formal të shoqatës “Impetus”, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ajo është regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Po kështu, kërkesa drejtuar Gjykatës është nënshkruar nga personi i autorizuar nga drejtori ekzekutiv i shoqatës, i cili, sipas statutit, gëzon të drejtën e përfaqësimit të kërkuar në marrëdhënie me të tretët. Në kërkesën e saj kërkuar shfuqizimin e ligjit nr. 38/2021, duke pretenduar se ai cenon parimin e sigurisë juridike në lidhje me parimin e proporcionalitetit; identitetin kombëtar, në drejtim të trashëgimisë kombëtare e kulturore; të drejtën për t'u informuar për gjendjen e mjedisit; të drejtat dhe liritë me karakter ekonomik, pronësor, social e kulturor të lidhura me të drejtën për një mjedis të shëndetshëm; lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe konkurrencën e lirë në lidhje me parimin e barazisë përpara ligjit; MSA-në, TKE-në dhe TFBE-në.

20. Duke i vlerësuar qëllimet e veprimtarisë së shoqatës “Impetus” në raport me kërkimet dhe argumentet e parashtruara prej saj për antikushtetutshmërinë e dispozitave të ligjit nr. 38/2021, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se edhe argumentet e parashtruara prej saj në drejtim të legjitimitetit për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues konkret vlerësohen të natyrës së përgjithshme, pasi kërkuar nuk ka paraqitur asnjë provë në drejtim të veprimtarisë së deritanishme të kryer prej saj për mbrojtjen gjyqësore të kategorive të subjekteve, të drejtat e të cilave ajo mbron sipas statutit, duke mos arritur të parashtojë argumente bindëse se si qëllimet e veprimtarisë së saj shtrihen në drejtim të përfaqësimit gjyqësor të kategorive të prekura nga zbatimi i ligjit ose në drejtim të ushtrimit të kontrollit kushtetues të ligjit objekt kërkesë. Në analizë të statutit të kësaj organizate, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se qëllimet më të afërta të veprimtarisë së saj me kërkimet e parashtruara në drejtim të kushtetutshmërisë së ligjit nr. 38/2021 janë ato të mbrojtjes së kauzave të qytetarëve shqiptarë kundrejt veprimtarisë së institucioneve publike, mbrojtjes së standardeve dhe praktikave më të larta mjedisore, si dhe ato në drejtim të lejeve zhvillimore e ndërtimore. Edhe në lidhje me këto aspekte të veprimtarisë së saj, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se shoqata “Impetus” nuk ka arritur të provojë ushtrimin e aktivitetit të saj në këtë drejtim.

21. Po kështu, edhe për sa u përket interesave të anëtarëve të saj ose të subjekteve që ajo mbron, sipas statutit, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kjo kërkuese nuk ka arritur të provojë në terma konkretë përpara Gjykatës ushtrimin e veprimtarisë së saj në drejtim të mbrojtjes gjyqësore të kategorive të subjekteve, të drejtat e të cilave ajo mbron ose të përcaktojë ndikimin dhe cenimin konkret të të drejtave të tyre nga zbatimi i ligjit të kundërshtuar në drejtim të pasojave të drejtpërdrejta e reale ose potenciale të shkaktuara këtyre interesave.

22. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se shoqata “Impetus” nuk legjitimohet *ratione personae* për vënien në lëvizje të Gjykatës për kontrollin kushtetues të ligjit nr. 38/2021.

23. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkesa e paraqitur nga qendra “Res Publica” dhe shoqata “Impetus” nuk plotëson kriteret për kalimin e saj në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të kërkesës së paraqitur nga kërkueset, qendra “Res Publica” dhe shoqata “Impetus”, me objekt: “*Shfuqizimi i ligjit nr. 38/2021, datë 23.03.2021 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë “Bechtel International Inc”, për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, ne, gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Gent Ibrahimimi dhe Marjana Semini, jemi kundër qëndrimit të shumicës për moskalimin e çështjes në seancë plenare, pasi vlerësojmë se kërkesa përmbush kriteret paraprake të pranueshmërisë, përfshi atë të legjitimitetit *ratione personae*.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se në datën 04.05.2023 kërkueset, së bashku me dy organizata të tjera (Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe shoqata “Për mbrojtjen e pronave dhe të mjedisit të pellgut të Drinit të Zi”), i janë drejtuar Gjykatës me të njëjtën kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr. 38/2021, duke pretenduar se ai cenon disa parime dhe të drejta kushtetuese. Në datën 26.06.2023 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur ndarjen e çështjes dhe shqyrtimin veçmas të kërkesës së dy kërkueseve nga ajo e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe shoqatës “Për mbrojtjen e pronave të mjedisit të pellgut të Drinit të Zi” dhe pas analizës së qëllimit të veprimtarisë së dy kërkueseve, sipas statuteve respektive të tyre, ka vlerësuar se asnjëra prej tyre nuk legjitimohet *ratione personae* (shih paragrafin 23 të vendimit).

3. Kështu, për sa i takon kërkueses, qendrës “Res Publica”, shumica ka dalë në përfundimin se veprimtaria e saj nuk rezulton të jetë e lidhur mjaftueshmërisht me ligjin e kundërshtuar dhe se ajo nuk ka arritur të provojë përpara Gjykatës se në çfarë mase anëtarët e saj ose subjektet, interesat e të cilëve ajo mbron, janë në marrëdhënie të tilla që rregullohen nga ligji i kundërshtuar, si dhe se sa reale ose potenciale është pasoja që pretendohet se u është shkaktuar interesave të tyre. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, shumica ka konsideruar këto rrethana: (i) asnjë nga qëllimet e veprimtarisë së saj nuk mund të konsiderohet se e legjitimon atë në këndvështrimin kushtetues për kundërshtimin e normës ligjore konkrete; (ii) fakti se ajo gëzon personalitet juridik sipas ligjit dhe se interesi i përgjithshëm publik për sundimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës e legjitimon atë në kontrollin kushtetues të normës konkrete, mbështetet në argumente që kanë karakter të përgjithshëm dhe nuk rezulton të jenë të lidhura me veprimtarinë që ajo ushtron; (iii) edhe nëse do të pranohej se norma e kundërshtuar prek atë pjesë të veprimtarisë së kërkueses që synon mbrojtjen e mjedisit, ajo nuk ka arritur të provojë konkretisht cenimin e veprimtarisë së saj praktike në këtë drejtim; (iv) ajo nuk ka arritur të

individualizojë ose të përcaktojë në nivel kushtetues ndikimin e drejtpërdrejtë të ligjit të kundërshtuar në interesat e anëtarëve të saj ose të subjekteve, interesat e të cilëve mbron (*shih paragrafët 15 dhe 16 të vendimit*).

4. Ndërsa, për sa i takon kërkueses tjetër, shoqatës “Impetus”, shumica ka vlerësuar se ajo nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi: (i) argumentet e parashtruara prej saj në drejtim të legjitimitimit janë të natyrës së përgjithshme, sepse nuk ka paraqitur asnjë provë në drejtim të veprimtarisë së deritanishme të kryer prej saj për mbrojtjen gjyqësore të kategorive të subjekteve, të drejtat e të cilave ajo mbron sipas statutit, duke mos arritur të parashtrojë argumente bindëse se si qëllimet e veprimtarisë së saj shtrihen në drejtim të përfaqësimit gjyqësor të kategorive të prekura nga zbatimi i ligjit ose në drejtim të ushtrimit të kontrollit kushtetues të ligjit objekt kërkesë; (ii) nuk ka arritur të provojë në terma konkretë përpara Gjykatës ushtrimin e veprimtarisë së saj në drejtim të mbrojtjes gjyqësore të kategorive të subjekteve, të drejtat e të cilave ajo mbron ose të përcaktojë ndikimin dhe cenimin konkret të drejtave të tyre nga zbatimi i ligjit të kundërshtuar në drejtim të pasojave të drejtpërdrejta e reale ose potenciale të shkaktuara këtyre interesave (*shih paragrafët 20 dhe 21 të vendimit*). Sipas shumicës, kjo shoqatë nuk ka arritur të provojë as ushtrimin e aktivitetit të saj në aspekt të qëllimeve më të afërta me kërkimet e parashtruara lidhur me kushtetutshmërinë e ligjit nr. 38/2021, sikurse mbrojtja e kauzave të qytetarëve shqiptarë kundrejt veprimtarisë së institucioneve publike, mbrojtja e standardeve dhe e praktikave më të larta mjedisore, si dhe ato në drejtim të lejeve zhvillimore e ndërtimore (*shih paragrafin 20 të vendimit*).

5. Ne, gjyqtarët në pakicë, mbështetur në standardet e zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese për legjitimitimin e organizatave të shoqërisë civile, si dhe duke konsideruar qëllimet e veprimtarisë të secilës prej tyre, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica për arsyet e mëposhtme.

6. Gjykata në vitin 2007 ka vendosur standardin kushtetues të përgjithshëm për legjitimitimin e subjekteve të kushtëzuara, duke pranuar se interesi i një subjekti të tillë do të quhet i justifikuar nëse kërkuesi arrin të provojë se pasoja është e drejtpërdrejtë, pra rrjedh direkt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale dhe, sipas rastit, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit ose të organizatës respektive (*shih fjalinë e parë, të paragrafit të dytë, faqja 5, të vendimit nr. 40, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke ndjekur këtë standard, Gjykata në jurisprudencë të vazhdueshme ka pohuar se organizatat legjitimohen të vënë në lëvizje kontrollin kushtetues për çështje që lidhen me interesat e tyre, nëse provohet se norma e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së tyre.

Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti se dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo për kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (shih vendimet nr. 39, datë 15.12.2023; nr. 37, datë 01.12.2022; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 33, datë 08.06.2016; nr. 14, datë 21.03.2014; nr. 43, datë 06.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

7. Elementi përcaktues i legjitimitetit të organizatës për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, i pranuar nga jurisprudenca konstante e Gjykatës, është lidhja e drejtpërdrejtë dhe e individualizuar midis objektit të veprimtarisë së kërkueses dhe çështjes kushtetuese të paraqitur për shqyrtim. Ky standard është i normuar shprehimisht edhe në nenin 49, pikat 3, shkronja “d” dhe 4, të ligjit nr. 8577/2000, i cili parashikon se *“të drejtën për të filluar një kontroll mbi pajtueshmërinë e ligjit ose akteve të tjera normative me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare e kanë edhe organizatat, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë e tyre dhe të drejtat dhe liritë e anëtarëve të tyre, dhe se ato kanë detyrimin të provojnë në çdo rast se çështja lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta ose me qëllimet e veprimtarisë së tyre”*.

8. Në vijim të këtij arsytimi, duhet theksuar roli kyç që organizatat e shoqërisë civile, si shprehje e lirisë kushtetuese të organizimit të qytetarëve, luajnë në demokratizimin e shoqërisë. Ato monitorojnë vullnetarisht mënyrën se si ushtrohet pushteti publik dhe krijojnë forume për debatimin e politikave publike dhe shpërndarjen e informacionit për çështjet që prekin interesat e grupeve të ndryshme ose të shoqërisë në përgjithësi. Në këtë mënyrë, veprimtaria e organizatave civile është e domosdoshme në funksionimin e shtetit të së drejtës, pasi jo vetëm nxit debatin publik dhe ndërgjegjëson qytetarët për çështje me interes të gjerë, por ato shërbejnë edhe si mekanizma të dialogut konstruktiv midis qytetarëve dhe autoriteteve publike. Organizatat e shoqërisë civile, duke qenë të pavarura, janë partnerë jetikë të shtetit demokratik. Ato kanë aftësinë që me veprimtarinë e tyre vullnetare dhe të pavarur ta bëjnë

shtetin në të gjitha nivelet më të përgjegjshëm, llogaridhënës, gjithëpërfshirës dhe efektiv, duke i forcuar atij legjitimitetin dhe besimin e qytetarëve.

9. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, evidentojmë se kërkueset kanë pretenduar se ligji i kundërshtuar cenon parimin e sigurisë juridike në lidhje me parimin e proporcionalitetit; identitetin kombëtar, në drejtim të trashëgimisë kombëtare e kulturore; të drejtën për t'u informuar për gjendjen e mjedisit; të drejtat dhe liritë me karakter ekonomik, pronësor, social e kulturor të lidhura me të drejtën për një mjedis të shëndetshëm; lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe konkurrencën e lirë në lidhje me parimin e barazisë përpara ligjit; MSA-në, TKE-në dhe TFBE-në.

10. Ndërkohë, për sa i takon qëllimit të veprimtarisë së tyre, rezulton se qendra “Res Publica”, është themeluar në vitin 2010 dhe ka një listë të gjerë synimesh, ku, ndër të tjera, përfshihen mbrojtja e lirive dhe e të drejtave themelore, ofrimi i shërbimeve ligjore në proceset gjyqësore strategjike, këshillimi i institucioneve publike për çështje të hartimit të politikave të ndryshme, mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i kulturës dhe edukatës ndaj tij, mbështetja dhe zhvillimi i vlerave dhe traditave kulturore dhe historike, zhvillimi i zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo drejtim tjetër në interes të publikut, duke bashkëpunuar me grupet identitare për përmbushjen e qëllimit. Nga konsultimi i të dhënave publike konstatohet se kjo organizatë ka një aktivitet të pasur për çështje që lidhen me liritë dhe të drejtat themelore, si dhe me shtetin e së drejtës, duke përfshirë edhe paraqitjen e çështjeve në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ose ndërhyrjen në gjykim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*shih Sevdari kundër Shqipërisë, aplikimi nr. 40662/19, datë 13 dhjetor 2022*).

11. Edhe shoqata “Impetus”, e themeluar në vitin 2017, ka një listë të gjerë qëllimesh të veprimtarisë, ku përfshihen fuqizimi i aftësisë së qytetarëve dhe grupeve shoqërore për të ndikuar në të gjitha çështjet që prekin ata dhe komunitetet e tyre; mbrojtja e kauzave qytetare përkundrejt institucioneve dhe kompanive publike; respektimi nga entet publike ose private i ligjeve, standardeve dhe praktikave më të larta mjedisore për qytetarët shqiptarë; zhvillimi urban, planet, studimet urbanistike dhe lejet zhvillimore e ndërtimore që pasojnë si një shqetësim themeltar me të cilin po përballlet shoqëria, si dhe informimi e transparenca e qytetarëve nga organet që marrin këto vendime përpara dhe gjatë mbledhjeve. Gjithashtu, referuar të dhënave publike, konstatohet se shoqata në fjalë ka ushtruar aktivitete të ndryshme, që përfshijnë edhe paraqitjen e çështjeve në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

12. Për sa më lart, duke mbajtur në konsideratë standardet kushtetuese, rolin kyç të organizatave civile në shtetin e së drejtës, qëllimin e veprimtarisë së kërkueseve dhe

veprimtarinë konkrete të kryer prej tyre në raport me pretendimet kushtetuese në çështjen e paraqitur, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se qendra “Res Publica” dhe shoqata “Impetus” legjिमohen *ratione personae* për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues sipas objektit të kërkesës së tyre dhe kërkesa e tyre duhet të kalonte për shqyrtim në seance plenare.

13. Përveç sa më lart, vetëm unë, gjyqtarja Fiona Papajorgji, theksoj se në shqyrtimin dhe vlerësimin e kriterit të legjitimitetit *ratione personae* duhet të mbaheshin në konsideratë edhe faktet se: (i) kërkesa për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 38/2021 është paraqitur bashkërisht dhe njëkohësisht nga të katërta organizatat; (ii) natyra kushtetuese e pretendimeve të tyre ka qenë e njëjtë; (iii) dhe Gjykata ka pranuar tashmë në praktikën e saj shqyrtimin dhe vlerësimin e këtij kriteri edhe në seancë plenare. Nisur nga fakti se kërkesa është paraqitur në një akt të përbashkët nga katër organizata, për të cilën Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi kalimin e çështjes në seancë plenare vetëm për dy prej tyre (Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe shoqata “Për mbrojtjen e pronave dhe mjedisit të pellgut të Drinit të Zi), kam votuar edhe kundër ndarjes së çështjeve.

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Gent Ibrahimi